

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQERISE "V & K " sh.p.k.



Me vullnetin e lire te ortakeve:

1. VILSON CIPI, i biri i Tomorrit, i vitlindjes 1950, lindur dhe banues ne qytetin e Vlores,

2. KRESHNIK CIPI, i biri i Tomorrit, i vitlindjes 1958, lindur dhe banues ne qytetin e Vlores;

themelohet Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emrin " V&K "shpk.

Neni 1

Shoqeria do t'a kete Seline e saj ne lagjen "Pavaresia", rruga "Sadik Zotaj", prane ish Kombinatit te Konservave ne qytetin e Vlores. Sipas parashikimeve ne Statut mund te ngrihen qendra te tjera te dyta, dege, filjale apo agjensi edhe ne vende te tjera, brenda apo jashte vendit.

Neni 2

Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga 100.000 leke, eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te saj.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese (kuota) me vlere 1.000 leke sejcila kuote.

Ne mbledhjen themeluese eshte vendosur qe kapitali themeltar te jete i ndare 50% me 50% per sejcilin ortak.

Menyrat e tjeters imit, shtimit apo pakesimit te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise jane te percaktuara ne Statut.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe me pakice i te gjitha llojeve te konfeksioneve brenda dhe jashte vendit per importin dhe eksportin e tyre.

Neni 4

Organi me i larte drejtues i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Ne mbledhjen themeluese eshte vendosur qe administratore te Shoqerise "V&K"shpk

te jene te dy ortaket Wilson Çipi dhe Kreshnik Çipi. Kompetencat e ketyre organeve jane te percaktuara ne Statut.

Neni 5

Menyrat e shperndarjes se fitimit jane te percaktuara ne Statut.

Neni 6



Ky akt themelimi u nenshkrua nga ortaket ne te pese kopjet e barazvle-
peshme te tij ne pranine e noterit, sot me date 19/03/1998.

O R T A K E T

VILSON ÇIPI

Wilson Çipi
[Signature]

KRESHNIK ÇIPI

Kreshnik Çipi
[Signature]

.....
REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA VLORE

Nr. 1026 rep.
Nr. kol.
Vlore, me 19/03/1998

VERTETIM

Me ane te te cilit vertetoj se ortaket Vilson Çipi dhe Kreshnik Çipi e nenshkruan aktin e themelimit te shoqerise "V & K"sh.p.k. me vullnetin e tyre te lire dhe ne pranine time. Pas kesaj une noterja e vertetova dhe e regjistrova.

**NOTERIA
IRENA BIMO**

[Large handwritten signature]



STATUTI

I SHOQERISE "V&K"shpk.



I. EMERTIMI DHE SELIA

Neni 1 ; Eshte themeluar nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar me emrin " V & K "sh.p.k.

Neni 2 ; Shoqeria do t'a kete Seline e saj ne lagjen "Pavaresia", rruga "Sadik Zotaj", prane ish kombinatit te konservave ne qytetin e Vlores.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve mund te ngrihen qendra te tjera te dyta, dege, filjale apo agjensi edhe ne vende te tjera brenda apo jashte Shqiperise.

II. PERSONALITETI JURIDIK

Neni 3 ; Shoqeria e fiton personalitetin juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Shkalles se pare Tirane.

III. KAPITALI THEMELTAR

Neni 4 ; Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 100.000 leke. Ai eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te saj.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese (kuota) me vlere 1.000 leke sejcila kuote.

Neni 5 ; Ndermjet ortakeve kapitali themeltar eshte i ndare si me poshte:

1. VILSON ÇIPI 50% ose 50 kuota

2. KRESHNIK ÇIPI 50% ose 50 kuota

Neni 6 ; Ortaket kane te drejte te shtojne kuotat e tyre te kapitalit ne perputhje me vendimet e Asamblese.

Neni 7 ; Kuotat e kapitalit te Shoqerise mund te tjetersohen tek persona te trete. Njihet e drejta e parablerjes prej ortakeve. Nje e drejte

e tille mund te ushtrohet brenda 30 diteve nga dita e komunikimit te tjetersimit. Ne rast te tjetersimit te kuctave te kapitalit tek persona te tjere jo ortak, ne çdo rast ortakët kanë te drejten e propozimit te bleresit.

Ne rastet e trashëgimise do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.

IV. OBJEKTI I VEPRIMTARISE, KOHEZGJATJA

Neni 8 : Objekti i veprimtarise se Shoqerise " V & K " sh.p.k. do te jete; Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe me pakice i konfeksioneve te te gjitha llojeve, brenda dhe jashte vendit per eksportin dhe importin e tyre.

Shoqeria mund te shtoje objektin e veprimtarise, ne perputhje me vendimet e Asamblese se Ortakeve.

Neni 9 : Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete per 15 vjet, por me vendim te Asamblese se ortakëve, ky afat mund te zgjatet ose Shoqeria mund te prishet para kohe, sipas parashikimeve ne Statut.

V. ADMINISTRIMI

Neni 10: Organet administrative te Shoqerise jane:

- Asambleja e pergjithshme e ortakëve.
- Administratoret.

Neni 11: Asambleja perfaqeson teresine e Ortakëve dhe vendimet e saja, te marra ne baze te ligjit, jane te detyreshme per te gjithë ortakët.

Neni 12: Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve vendos per:

- Miratimin e Statutit dhe te ndryshimeve ne te.
- Miratimin e bilancit.
- Zgjedh administratorin (ose Keshillin administrativ).

-Pjesmarrjen ne Shoqeri te tjera vendese apo te huaja,prishjen e shoqerise para kohe,zgjatjen e afatit maksimal te veprimtarise se Shoqerise si dhe per qeshtje te tjera qe me ligj i takojne Asamblese se ortakeve.

Neni 13: Cdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron.Ortaket mund te perfaqesohen ne Asamble nga te tjere ortake ose persona te tjere te besuar prej tyre,gjithmone me prokure te leshuar sipas ligjit.

Neni 14: Ne mbledhjet e Asamblese,vendimet merren nga nje ose disa Ortake qe zoterojne me shume se gjysmen e kuotave te kapitalit.Ne rast se kjo nuk sigurohet ortaket thirren ne konsultim per here te dyte dhe vendimet merren me shumice votash,pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe perfaqesojne(Asambleja e zakoneshme). Per ndryshimet ne Statut,zgjatjen e afatit te veprimtarise,pri- shjen e Shoqerise para afatit,tjetersimin e kuotave te kapitalit, ose shtimin e tyre me kerkesen e ortakut,eshte e nevojshme qe vendimet te merren me votat e zoteruesve te tre te katertave te kuotave te kapitalit themeltar(Asambleja e jashtezakoneshme).

Neni 15: Zvogelimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e ortakeve(e jashtezakoneshme).Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit te perfaqesuar.

Neni 16: Ne mbledhjen themeluese eshte vendosur qe administratore te Shoqerise " V & K " sh.p.k. te jene ortaket Vilson Çipi dhe Kreshnik Çipi,te cilet perfaqesojne shoqerine ,veç e veç ose te dy se bashku,ne mardhnie me te tretet,kane te drejten e perfaqesimit gjyqesor si dhe te drejten e firmes ne banka. E drejta e firmes ne banke eshte e alternuar dhe terheqjet mund te behen edhe nga sejcili ortak i veçante.



Neni 17: Veprimtaria vjetore e Shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti.

Raporti i administrimit, inventaret, bilanci dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratori ,i nenshtrohen miratimit te asamblese se ortakeve, brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Ne perfundim te mbylljes se bilancit Asambleja percakton menyren shperndarjes se fitimit, likuidimin e detyrimeve dhe percaktimin e rezerves ligjore, e cila nuk mund te jete me e vogel se 5 % te fitimit.

VI. PRISHJA E SHOQERISE

Neni 18: Shoqeria mund te priset para afatit te percaktuar ne statut:

1. Me unanimitetin e Ortakeve.

2. Pas dy vjeteve me bilanc negativ, me vendim te asamblese se jashte zekoneshme te ortakeve.

VII. DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 19: Shoqeria" V & K "sh.p.k. do te kete siglen e vulen e saj.

Neni 20: Ky statut u miratua ne mbledhjen themeluese te Shoqerise dhe nenshkruhet nga te gjithë ortaket ne te pese kopjet e barazvlereshme te tij, sot me date 19/03/1998, para noterit.

O R T A K E T

VILSON ÇIPI
Vilson Çipi
[Signature]

KRESHNIK ÇIPI
[Signature]

.....
REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA VLORE

Nr. 1028/Rep.

Nr.Kol.

Vlore, me 19/03/1998

V E R T E T I M

Me ane te te cilit vertetoj se ortaket e Shoqerise" V & K "sh.p.k.e nenshkruan Statutin e Shoqerise me vullnetin e tyre te lire dhe ne pranine time. Pas kesaj une noterja e vertetova dhe rregjistrova.



NOTERE
IRENA BIMQ
[Signature]